



2025 NËNTOR

Mbrojtja në një muaj



MINISTRI I MBROJTJES, PIRRO VENGU, URON SHQIPTARËT

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, ka uruar qytetarët shqiptarë për ditët e shënuara të Pavarësisë dhe Çlirimit! Ai i vlerësoi këto dy data si dy momente kyçe të historisë dhe identitetit tonë kombëtar. Po ashtu urime kanë ardhur edhe nga efektivistët e Forcave të Armatosura që shërbejnë në vend, por edhe nga ata që ndodhen larg në misone.

★★★★★

mod.gov.al

MM



EKSPOZITË NË NDER TË HERONJËVE RILINDAS

Në një bashkëpunim mes Muzeut të Forcave të Armatosura dhe Bibliotekës Kombëtare u zhvillua ekspozita “Ja të vdesim, ja të rrojmë”, e cila përmes fotografive, dokumenteve dhe artefakteve historike sjell për publikun sakrificën dhe përkushtimin e heronjve tanë rilindas. Ekspozita ka për qëllim ruajtjen dhe promovimin e kujtesës historike të këtyre figurave, duke ofruar një përvojë të gjallë dhe reflektive për vizitorët.

★★★★★

mod.gov.al



MOTI I KEQ, FA DHE EMERGJENCAT CIVILE NË GADISHMËRI

Gjatë muajit nëntor, Forcat e Armatosura, në bashkëpunim me ekipet e Emergjencave Civile dhe pushtetin vendor, u angazhuan gjerësisht në menaxhimin e situatës së shkaktuar nga moti me reshje, duke dislokuar mbi 900 efektivë në terren. Me përdorimin e qindra mjeteve ushtarake dhe teknike realizuan evakuime, ndërhyrje inxhinierike dhe hapjen e akseve të bllokuara. Ky angazhim i koordinuar kontribuoi në minimizimin e dëmeve dhe në mbështetjen e banorëve në zonat e prekura. Ekipet e Emergjencave Civile dhe efektivët e Forcave të Armatosura mbeten gjithmonë në gadishmëri për të ndërhyrë në rast të përkeqësimit të motit.

★★★★★



FORCAT E XHENIOS NË TERREN

Batalioni i Xhenios është vendosur në krye të operacioneve në disa zona të goditura nga reshjet e ditëve të fundit, përfshirë Sarandën, Finiqin, Maliqin, Laçin dhe Bovillën, ku po vijon puna për rehabilitimin e infrastrukturës pas dëmtimit të disa urave si pasojë e motit të keq. Ekipet janë plotësisht të angazhuara për rikthimin e sigurisë dhe funksionalitetit në të gjitha zonat e dëmtuara.

★★★★★

mod.gov.al

MM

A man in a dark suit and glasses is speaking at a wooden podium with microphones. The background is a red wall with wood paneling.

MIRATOHET NË PARIM BUXHETI PËR VITIN 2026

Gjatë fjalës në seancën plenare për shqyrtimin në parim të Buxhetit të Mbrojtjes 2026, ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu theksoi se ky buxhet shënon një kthesë të rëndësishme për modernizimin e Forcave të Armatosura, ringritjen e industrisë ushtarake shqiptare dhe forcimin e kapaciteteve të emergjencave civile. Një pjesë e rëndësishme, 13 miliardë lekë, shkon për personelin me uniformë, duke përfshirë rritje pagash, përmirësim të kushteve të jetesës dhe zgjerim të mundësive të karrierës për të rinjtë që synojnë t'i bashkohen Forcave të Armatosura ose strukturave të Mbrojtjes Civile

★★★★★

mod.gov.al

MM

A photograph showing four officials in formal attire signing a document. In the background, the circular seal of Palazzo Chigi is visible. The seal features a central emblem with a crown and a shield, surrounded by the text 'PALAZZO CHIGI' and 'REPUBBLICA ITALIANA'.

SHQIPËRI-ITALI MARRËVESHJE NË FUSHËN E MBROJTJES

Në kuadër të samitit të parë ndërqeveritar mes Shqipërisë dhe Italisë, të mbajtur në Romë nën drejtimin e kryeministres italiane Giorgia Meloni dhe kryeministrit Edi Rama, u firmos një marrëveshje e rëndësishme në fushën e Mbrojtjes mes dy vendeve. Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu dhe homologu i tij italian, Guido Crosetto nënshkruan “Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë për bashkëpunimin në fushën e Mbrojtjes”, e cila synon forcimin e mëtejshëm të partneritetit strategjik dhe të sigurisë dypalëshe.

★★★★★



SHQIPËRI-ITALI ZGJEROJNË BASHKËPUNIMIN NË MBROJTJE

Në Samitin Ndërqeveritar të mbajtur në Romë, Ministria e Mbrojtjes e Italisë dhe ajo e Shqipërisë firmosën disa marrëveshje bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes. Marrëveshjet mbulojnë zhvillimin e industrisë ushtarake, forcimin e kapaciteteve të emergjencave civile dhe modernizimin e forcës detare, duke forcuar partneritetin strategjik mes dy vendeve.

★★★★★

mod.gov.al

MM



MINISTRI VENUGU INSPEKTON PUNIMET

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, inspektoi punimet në Pöcest, ku po ndërtohet godina e re e Batalionit III të Këmbësorisë së Jugut. Sipas ministrit, projekti po avancon me ritme të shpejta dhe pritet të sjellë standarde të reja në infrastrukturën ushtarake të vendit. Objekti i ri do të jetë një strukturë moderne, e konceptuar për të plotësuar të gjitha nevojat funksionale dhe stërvitore të efektivëve.

★★★★★

mod.gov.al

MM




ANIJA “LISSUS” SHPËTON 18 EMIGRANTË NË EGJE

Anija “Lissus” (P-133) ndërhyri në një operacion kërkim–shpëtimi, duke ndihmuar një gomone me 18 emigrantë. Falë ndërhyrjes së shpejtë dhe profesionalizmit të ekuipazhit, operacioni u përfundua me sukses.

★★★★★

mod.gov.al

MM



A photograph of Minister Pirro Vengu, wearing a dark suit and glasses, placing a large wreath of red and white flowers on a stone memorial. In the background, soldiers in red uniforms are visible. The memorial has a plaque with the text 'AUX 640 SOLDATS'.

MINISTRI VENGU NDERON TË RËNËT FRANCEZË NË KORÇË

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu mori pjesë në ceremoninë e 11 Nëntorit në Varrezat Franceze të Korçës, ku u nderuan 640 të rënët e Luftës së Parë Botërore. Ai theksoi miqësinë e hershme shqiptaro-franceze dhe rolin historik të Korçës në periudhën e vetëqeverimit shqiptar. Ministri u shpreh se kujtimi i të rënëve na rikujton se liria dhe paqja kërkojnë sakrificë dhe mbrojtje të përditshme.

★★★★★

mod.gov.al



REPARTI I DRENOVËS DREJT TRANSFORMIMIT

Reparti i amortizuar i Drenovës pritet të marrë një formë krejt të re falë investimit të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, një projekt që synon ta kthejë zonën në një aset me funksione të shumëfishta. Sipas planit të investimit, objekti do të shndërrohet në një hapësirë moderne në shërbim të Forcave të Armatosura, duke rritur kapacitetet funksionale dhe operacionale të tyre. Paralelisht, projekti parashikon krijimin e një qendre të re të turizmit dhe aventurës në natyrë, e cila pritet të tërheqë vizitorë dhe të nxisë aktivitete rekreative në zonën malore të Drenovës.

★★★★★



STËRVITJE SHQIPTARO-RUMUNE

Forcat e Armatosura të Shqipërisë zhvilluan një stërvitje dypalëshe me Ushtrinë Rumune në Sarajevë, në kuadër të misionit EUFOR “ALTHEA”. Aktiviteti synon forcimin e bashkëpunimit mes vendeve aleate dhe rritjen e gatishmërisë operacionale. Shqipëria vijon të kontribuojë në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në kuadër të EUFOR

★★★★★

mod.gov.al

MM



STËRVITJE NË BIZË

Në Bizë u zhvillua stërvitja komplekse fushore e 90 kursantëve të Kursit Bazë të Oficerit, nën drejtimin e instruktorëve të Shkollës së Trupës. Kursantët përballen me kushtet sfiduese të terrenit dhe motit, duke thelluar njohuritë profesionale dhe duke rritur aftësitë drejtuese nën ngarkesë fizike dhe psikologjike. Ushtrimet i vendosin ata përballë skenarëve të ngjashëm me situatat reale të fushës së operacioneve.

★★★★★

mod.gov.al

MM